



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE

Adresa: Rr. Reshit Çollaku" Tel 04 234 918, Fax. 04 228 516 Email: Info@hidaa.gov.al

Nr. Indeksi	2004
Viti i deklarimit	

DEKLARIM

I PASURIVE, TË DETYRIMEVE FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË
(Ligji Nr. 9049, Datë 10.04.2003)

Kush mbart detyrimin për deklarim:

Të gjithë subjektet (personat) që mbajnë funksionet e renditura në nenin 3 të ligjit.

Llojet e deklarimit, afati i plotësimit të deklaratës dhe objekti i deklarimit:

Sipas llojit të deklarimit vendosni në kuti shenjën 'X'.

- Deklarimi i parë apo para fillimit të punës** në një nga funksionet që të detyron të deklarosh pasurinë, duhet plotësuar brenda 30 ditëve të fillimit të detyrës.
 Në këtë lloj deklarimi duhet të pasqyrohen për deri më 31 Dhjetor të vitit paraardhës të gjitha pasuritë e akumuluar ndër vite, detyrimet financiare, burimet dhe origjina e pasurisë së vetë subjektit, bashkëshortit/es dhe të fëmijëve në moshë madhore me të cilët figuron në një përbërje familjare. (Lexo nenin 6, 9 dhe 21 të ligjit).

- Deklarimi vjetor** dorëzohet brenda datës 31 Mars të çdo viti. Në këtë lloj deklarimi duhet të pasqyrohen vetëm ndryshimet në gjendjen e pasurive për periudhën nga 1 Janari deri më 31 Dhjetor të vitit paraardhës, burimet e krijimit të tyre, si dhe detyrimet financiare të vetë subjektit, bashkëshortit/es dhe të fëmijëve në moshë madhore me të cilët figuron në një përbërje familjare. (Lexo nenin 4 të ligjit).

- Deklarimi pas largimit nga funksioni** duhet plotësuar deri 2 vjet (2 deklarime vjetore) pas largimit nga funksioni dhe deri në 4 vjet (4 deklarime vjetore) për disa lloj funksionesh. (Lexo nenin 8 të ligjit). Llogarita e këtij deklarimi është 31 Dhjetori i vitit paraardhës.

- Deklarimi me kërkesë bëhet** me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm ndaj personave juridikë e fizikë të lidhur me subjektin që mbart detyrimin për deklarim të pasurisë. (Lexo nenin 7 të ligjit).

Pyetje, ndihmë dhe ku do të merret e dorëzohet deklarata:

Të gjithë subjektet janë të detyruar të marrin e të dorëzojnë dokumentin deklaratë pranë Inspektoratit të Ulët të ngritur në Institucionet ku kryejnë funksionin apo ku kanë punuar deri pas largimit nga funksioni, sipas rastit mund edhe të kërkohet ndihmë për plotësimin e saj po në Inspektoratin e Ulët. (Lexo nenin 18, 19, 23 të ligjit).

Në qoftë se ju keni pyetje të tjera kontaktoni me ILDKP në numrin pa pagesë 0800 9999, si dhe në numrin 234 918. Për më tepër informacion mund të drejtoheni në: www.hidaa.gov.al

- Masat administrative:** Refuzimi për deklarim sjell humbjen e funksionit, publikimin, ndëshkimin në përputhje me Kodin Penal. (Lexo nenin 5 të ligjit).

Kur deklarata dhe dokumentet shoqëruese nuk paraqiten në afatin e caktuar, pa shkaqe të arsyeshme, subjekti gjobitet me 25000 lekë. Në qoftë se deklarata nuk dorëzohet edhe 15 ditë pas komunikimit të gjobës njoftohen organet përkatëse dhe gjoba dyfishohet. (Lexo nenin 40 të ligjit).

Vërtetoj se deklarimet e bëra në vijim nga unë janë të plota, të vërteta, të sakta dhe mbaj përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e tyre.

TË DHËNAT PERSONALE

Emri	Atësia	Mbiemri
ZEQIR	XHAFER	HODA
Funksioni	Institucioni	
PROKUROR RRETHI	PROKURORIA RRETHIT CRUJE	
Adresa e Institucionit		Vendi
LAGJIA VRK. 1	KRUJE	KRUJE
Data e emërimit në detyrë	Data e largimit nga detyra	Data e dorëzimit të deklaratës
11.05.2002		25.05.2005
Nënshtrimi		

Sipas nenit 34 të ligjit, të dhënat e deklaratës publikohen, përvèç të dhënavë të faqes 7 dhe 8.



PASURITË E PALUAJTSME DHE TË LUAJTSME

Në këtë seksion do të pasqyroni pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme, (në emër të deklaruesit, bashkëshortit/es dhe fëmijëve madhorë) të ndodhura brenda ose jashtë Shqipërisë deri më datë 31 Dhjetor të vitit paraardhës.

Çfarë përfshihet në pasuritë e paluajtshme:

Toka, burime, rrjedhje uji, uzina, fabrika, dyqane, shtëpi e apartamente banimi, ndërtime të ndryshme si hoteleri, pikë karburanti, magazina, pishina etj. mbi të cilat ju ushtronin një të drejtë reale, pavarësisht nëse janë të regjistruara ose jo në Z.R.P. të Paluajtshme. (Në kolonën përkatëse do të përshkruani me hollësi pronën, si p.sh. sasinë në natyrë, sip. në m², vlerën e pronës, vitin e ndërtimit etj).

Çfarë përfshihet në pasuritë e luajtshme:

Të gjitha mijet motorike për të cilat është i detyrueshëm regjistrimi në një organ shtetëror siç janë: zyrat notoriale, tatimore, drejtoritë e shfrytëzimit të automjeteve, kapitneria e porteve, të regjistrat hekurudhor, ajror, gjykata, banka etj. pasuritë e tjera të luajtshme si sende që kanë një vlerë të veçantë mbi 5000 dollarë amerikanë (ose ekuivalenti në çdo monedhë tjetër), aksione, letra me vlerë, gjendje cash, pjesë kapitali në zotërim, likuiditete në bankë, duke përfshirë këtu edhe depozitat përfshirë apo personat që keni në ngarkim etj. (Lexo nenin 4 të ligjit).

Kujtesë: Në deklarimin vjetor do të pasqyroni vetëm ndryshimet e ndodhura në pasurinë tuaj gjatë një viti.

Të dhënat për pasuritë që do të deklaroni, si p.sh. numrat e regjistrave të Z.R.P.P., numra të ndryshëm të regjistrave publikë, emra të personave të cilëve u keni dhënë hua në lekë apo në valutë të huaj etj., që ju e çmoni se janë konfidenciale, do t'i shënoni në faqen 7, e cila nuk do të publikohet.

Përshkrimi i hollësishëm i çdo lloj pasurie (Lexo nenin 21 të ligjit)	Vlera e secilës pasuri në lekë apo në valutë, në momentin e krijimit (e shprehur me shifra dhe me fjalë)	Pjesa që zoteron (në %, sasi apo vlerë)	Data dhe viti i krijimit të pasurisë
1 <i>Shtëpi baniuci, me nj. 107.9 m²</i>	3.900.000 <i>(Tre milion e ratusë 100.</i>	100	22/11/2001
2 <i>Gjendje në cash 200.000 /€</i>	200.000 /€	100	2004
3			
4			
5			

Deklarimi është i pavlefshëm nëse nuk pasqyroni identitetin e firmën.

Nëse kjo tabelë është e pamjaftueshme mund të vazhdoni në faqen 4.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi



PASURITË E PALUAJTSHME DHE TË LUAJTSHME

Përshkrimi i hollësishëm i çdo lloj pasurie (lexo nenin 21 të ligjit)	Vlera e secilës pasuri në lekë apo në valutë, në momentin e krijimit (e shprehur me shifra dhe me fjalë)	Pjesa që zoteron (në %, sasi apo vlerë)	Data, viti i krijimit të pasurisë
6			
7			
8			
9			
10			
11			
12			

Deklarimi është i pavlefshëm nëse nuk pasqyroni identitetin e firmën.

Emri, Mbiemri, Nënshtkimi



DETÝRIMET FINANCIARE NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË

Deklarimi i detyrimeve financiare si kërkesë e nenit 4 të ligjit do ndihmojë në argumentimin e drejtë të pasurisë së vënë ndër vite apo gjatë një viti.

Çfarë detyrimesh do të përfshihen:

Në tabelën e mëposhtme duhet të renditen të gjitha detyrimet financiare (kredi, hua, borxh etj.) që keni patur ose keni ju, bashkëshorti/ja dhe fëmijët madhorë (që keni në përbërjen familjare) dhe që ju kanë shërbyer për të krijuar pasuri të ndryshme të paluajtshme apo të luajtshme.

Detyrimet do të shprehen në lekë apo në valutë sikurse është bërë akt-marrëveshja, të tregohet shkaku i marrjes, shuma e marrë, kohëzgjatja dhe personi huadhënës sipas tabelës së mëposhtme.

Plotësoni dy kolonat e fundit në lekë apo në valutë (me shifra dhe me fjalë)

Përshkrimi i hollësishëm i detyrimit finanziar. (shuma e marrë, kohëzgjatja, interesë bazë, etj.)	Numri dhe data e kontratës (nëse ka)	Ndaj kujt keni detyrime financiare	Shuma e detyrimit finanziar (+interesa) e <u>shlyer</u> deri më 31 Dhjetor	Shuma e detyrimit finanziar (+interesa) e <u>pashlyer</u> deri më 31 Dhjetor
1 <i>KREDI 7.000 \$ 5 vjet 08/08/2002 - 08/08/2007</i>				
2				
3				
4				
5				

Deklarimi është i pavlefshëm nëse nuk pasqyroni identitetin e firmën.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

TË ARDHURAT

Çfarë përfshihen në të ardhurat:

Të ardhurat vjetore nga paga, shpërblime, pjesëmarrja në borde, komisione apo çdo veprimtari tjeter që sjell të ardhura, shitja apo qiraja e përfituar nga objekte të ndryshme të luajtshme apo të paluajtshme, të ardhurat që përfitohen nga licencat dhe patentat, të ardhurat individuale që përfitohen nga qenia ortak apo pjesëmarrës në kapital në shoqëritë fitimprurëse (shuma e dividendid apo fitimit të tërhequr nga biznesi ku subjekti është pjesëmarrës) ose të ardhurat nga çdo lloj përfshirje në organizatat jofitimprurëse, përqindjet e përfituar nga depozitat bankare apo nga hyadhënet e realizuara me personat juridikë e fizikë, si dhe çdo lloj e ardhure tjeter.

Kujtesë:

Në deklarimin e parë apo para fillimit të detyrës, subjekti duhet të deklarojë edhe të ardhurat e realizuara në përgjithësi ndër vite: personale, të bashkëshortit/es dhe fëmijëve që ka në përbërjen familjare.

Në deklarimin vjetor, subjekti duhet të deklarojë të gjitha të ardhurat e siguruara deri më 31 Dhjetor të vitit paraardhës, si ato personale, të bashkëshortit/es dhe fëmijëve që ka në përbërje familjare.

Pershkrimi më vete i çdo lloj të ardhure për secilin pjesëtar të familjes së subjektit dhe mënyra e sigurimit të këtyre të ardhurave	Shuma faktike e të ardhurave vjetore që kanë qenë në disponim të personit e familjes, në lekë apo në valutë (e ardhura neto, me shifra dhe me fjalë)	Vendi i punës, emërtimi i aktivitetit nga i cili janë siguruar të ardhurat, adresat përkatëse
1 Paga ime si subjekt aktivo Paga e pasurishtorres	1.094.955 (një milion e neshtënjë e katëruinë e pesëdhjetë e pesë) / 1.094.955 (një milion e njëdhjetë e katëruinë e pesëdhjetë e pesë)	PROKURORI I KRAJE ^{1.094.955}
2	649.373 (një milion e njëdhjetë e katëruinë e pesëdhjetë e tre)	D.T.N. TELEKOM TIRANE
3		
4		
5		
6		
7		

Deklarimi është i pavlefshëm nëse nuk pasqyroni identitetin e firmën.

Emri, Mbiemri, Nënshtkrimi



AUTORIZIM
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË PASURISË

Në zbatim të nenit 10 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", Unë

Zogj Hado si subjekt i deklarimit për datën
të panarrave

si subjekt i detyrimit për deklarim të pasurisë nën përgjegjësinë time, autorizoj Inspektoratin e Lartë/ të Ulët ose çdo person tjetër të autorizuar nga Inspektori i Përgjithshëm, të ushtrojë çdo lloj kontrolli mbi vërtetësinë, saktësinë dhe burimet e pasurive personale dhe familjare, që ndodhen brenda dhe jashtë Shqipërisë, në të gjitha subjektet, publike dhe private.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Zogj Hado

Dorëzuar më datë

Adresa e kontaktit

Për çdo ndryshim të mundshëm, njoftoni pranë Inspektoratit të Lartë/ Ullët.

Telefon Privat

Celular Privat

E-mail

Kujtesë:

Deklarata dhe të gjitha dokumentet që e shoqërojnë atë janë dokumente zyrtare.

Ekzistojnë sanksione ligjore administrative dhe penale në rast të fshehjes ose të deklarimit të rremë të pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë. (Lexo nenin 5, 28, 31, 32 dhe 38 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", si dhe nenin 257/a të Kodit Penal).